

Noter

George Sami Al Maaushi  
17 shtator 2004  
(Nenshkrimi, vula)



Marreveshje per transferimin e kuotave te Shoqerise

**“ FUSHE KRUJA CEMENT FACTORY SH.P.K”**

Palet :

**RMC ECF CONSORTIUM HOLDING S.A.L**  
Regjistri Tregtar i Veçante i Bejrutit nr. 1061  
Perfaqesuar nga Administratori **Z. Alexandre Bouri**  
I autorizuar per te nenshkruar ne emer te Shoqerise

Pala e Pare

**SEAMENT HOLDING S.A.L.**  
Regjistri Tregtar i Vecante i Beirutit nr. 490  
Perfaqesuar nga Zv. Administrator i Pergjithshem **Z.Jacques Sehnaoui**  
I autorizuar per te nenshkruar ne emer te Shoqerise

Pala e dyte

Te dyja palet kane caktuar si vend per qellimet e kesaj Marreveshje Vilen 48, ne Shukri Shammas Street, First Avenue, Rabieh-Lebanon

Shoqeria Kuotat e te ciles transferohen:

“FUSHE KRUJA CEMENT FACTORY SH.P.K” regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne Tirane-Shqiperi me vendim numer 24373.

Data e Transferimit: 06/09/2004

Preambula:

Meqenese Pala e Pare aktualisht zoteron 1.200.000 (nje milion e dyqind mije) kuota te Shoqerise Shqiptare “FUSHE - KRUJA CEMENT FACTORY SH.P.K”, te cilat perfaqesojne te gjithe kapitalin e saj, dhe ku vlere e cdo kuote eshte nje mije Leke; dhe deshiron t’ia transferoje keto kuota Pales se Dyte,

Meqenese Pala e Dyte e ka pranuar kete transferim,

Palet kane rene dakord per sa me poshte vijon:

**Marreveshja:**

1. Preambula e mesiperme perben nje pjese integrale dhe te pandashme te kesaj marreveshje.
2. Pala e Pare, zoteruese e 1.200.000 (nje milion e dy qind mije) kuotave ne shoqerine Shqiptare "FUSHE KRUIJA CEMENT FACTORY SH.P.K", ia transferon pronesine mbi to Pales se Dyte dhe kjo e fundit pranon.
3. Ky transferim behet per nje cmim total prej 9.486.351 USD (nente milion e katerqind e tetedhete e gjashte mije e tre qind e pesedhete e nje US Dollar). Pala e Pare e shkarkon Palen e Dyte nga pergjegjesia e saj ne lidhje me cmimin e kuotave te transferuara dhe prej cdo te drejte ose pretendim lidhur me to.
4. Pala e Pare deklaron qe kuotat e transferuara nepermjet kesaj marreveshje nuk jane objekt i ndonje kufizimi apo garancie.
5. Pala e Dyte, nepermjet ketij transferimi, merr persiper te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga pronesia mbi kuotat e transferuara.
6. Pala e Pare, ne baze te ligjeve ne fuqi, merr persiper te nise procedurat e duhura ose masat perkatese per transferimin e pronesise te ketyre kuotave tek Pala ne favor te se ciles do te behet transferimi.
7. Kjo marreveshje me dy faqe perpilohet ne arabisht dhe anglisht ne dy kopje dhe nenshkruhet nga te dyja Palet. Secila prej tyre do te mbaje nga nje kopje.

*Lexuar, miratuar dhe nenshkruar nga Pala e Pare dhe e Dyte, te cilat zgjedhin si vend per qellimet e kesaj marreveshje ate te percaktuar ne adresen e siperpermendur.*

**Pala e Pare**

**RMC ECF CONSORTIUM HOLDING S.A.L**  
(nenshkrimi)

**Pala e Dyte**

**SEAMENT HOLDING S.A.L**  
(nenshkrimi)

**Nr. 2831/2004**

Vertetohet se sot ne daten 17 shtator 2004 **Z. Jacques Sehnaoui dhe Z. Alexandre Bouri** u paraqiten dhe deklaruan para meje noterit se kane lidhur kete kontrate ne daten e sipershenuar.

**Noteri**

George Sami Al Maaushi  
(Nenshkrimi, vula, pulla)

**Ministria e Drejtesise**

Kancelaria e gjykates  
Zyra e vertetimit

Vertetohet se vula dhe firma e noterit e vendosur ne kete dokument eshte e sakte.

Bejrut 10 dhjetor 2004.

Gjyqtar Rizkallah Xhemil Shehab

(Nenshkrimi, vula)

**Republika e Libanit**

**Ministria e Puneve te Jashtme dhe Migrimit**

Sektori i Legalizimit


Nr. 5/07A

Bejrut, me 11 dhjetor 2004

Vertetohet nenshkrimi i Z. Shehab

(Nenshkrimi, vula)

**Perktheu:**

  
(Anwar Rizeq)


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr. 14874 Rep.

Tirane, me 21.12.2004

### VERTETIM

Me ane te te cilit vertetohet firma e perkthyesit Anwar Rizeq, banues ne Tirane, i njohur personalisht prej meje, i cili u paraqit duke me deklaruar se e ka perkthyer dokumentin bashkengjitur ne perputhje me origjinalin nga arabishtja ne shqip dhe firmosi rregullisht ne pranine time.



NOTER

